



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK**

STUDIMET MASTER

**PLANPROGRAMI I LËNDËS
KONTROLLI GJYQËSOR I ADMINISTRATËS
– STUDIM KRAHASIMOR**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Kontroli Gjyqësor i Administratës – Studim Krahasimor
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2021/22
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	//
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Islam Pepaj
Detajet kontaktuese:	islam.pepaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë në punën (veprimtarinë) e administratës duhet të ushtrohet përveç formave tjera të kontrollit, edhe kontrolli gjyqësor i ligjshmërisë së punës së administratës.</p> <p>Në çdo shtet rregullohet organizimi i gjyqësisë dhe procedura e kontrollit të ligjshmërisë të punës së administratës. Andaj, studimi i kësaj problematike mundëson që të njihemi me kontrollin gjyqësor të administratës, përkatësisht procedurën e ushtrimit të këtij kontrolli, si dhe konstatimin e gjendjes së vërtetë dhe dallimin midis asaj që është proklamuar me norma dhe realizimit të saj në praktikë.</p> <p>Kontroli gjyqësor i punës së administratës ushtrohet me qëllim të realizimit të ligjshmërisë në punën e administratës dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve nga puna e paligjshme dhe e parregullt e organeve të administratës dhe të shërbimeve publike .</p> <p>Kontroli gjyqësor i punës së administratës është rrugë gjyqësore për mënjanimin e paligjshmërive e që mund të aplikohet tek pasi paraprakisht të konsumohet rruga administrative e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridike individuale.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i studimit të kësaj lënde është përqendruar në çështje teorike dhe praktike të kontrollit gjyqësor të administratës në vendin tonë si dhe në aspektin krahasimor.</p> <p>Qëllimi themelor i studimit të kësaj lënde është që studentët të njoftohen me bazat e përgjithshme konceptuale të doktrinës dhe praktikës së kontrollit</p>

	gjqësor të administratës si dhe me zgjidhjet teorike dhe ligjore të kontrollit të administratës në vendin tonë dhe në aspektin krahasues.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të kësaj lënde, synohet që studentët të familjarizohet më tepër për sistemet juridike sa i përket kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative në përgjithësi dhe formën e aplikimit të institutit të Gjyqësisë Administrative në Republikën e Kosovës në veçanti. Gjithashtu synohet që studentët të pajisen me informacionin e duhur për parimet dhe rregullat e funksionimit të Administratës Publike në përgjithësi.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithësej
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/14	28
Punë praktike	1	1/14	14
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/14	14
Ushtrime në teren	1	1/6	6
Kollokfiime,seminare	3	3/3	9
Detyra të shtëpisë	1	1/10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1/1	3
Projektet,prezantimet ,etj	3	1/4	12
Totali			171
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda do të mësohet përmes: - Trajtimit teorik të sistemeve juridike te kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative - Trajtimit komperativ të çështjeve duke evidentuar mangësitë dhe përparësitë në lidhje me këtë fushë në Kosovë dhe mundësitë për reformë. - Trajtimi dhe diskutimi i rasteve konkrete nga veprimtaria e administratës Publike në Kosovë. - Prezantime nga ana e studentëve të temave të		

	<p>caktuara nën mbikëqyrjen e Profesorit dhe hapja e debatit (mësimi interaktiv).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrimet dhe Seminaret si një proces interaktiv i mësimit për studentët, duke u bazuar në studimin e pavarur të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen nga ana e mësimitdhënësit të lëndës. - Trajtimi i shembujve të ndryshëm me qëllim të lehtësimit dhe të kuptuarit të lëndës nga studentët.
Metodat e vlerësimit:	<p>Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i parë 20% ▪ Vlerësimi i dytë 20% ▪ Punimi seminarik, detyrat e shtëpisë, puna praktike ose angazhimet tjera 20% ▪ Vijimi i rregullt 10% ▪ Provimi final 30% <p>- Totali 100%</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Dr.Sc. Esat Stavileci Nocione dhe parime te administratës publike, Prishtinë, 2005</p> <p>Dr.Sc. Esat Stavileci Hyrje ne shkencat administrative, Prishtine, 1997</p> <p>Dr.Sc. Agur Sokoli Kontrolli i punës se administratës dhe përgjegjësia politike e saj, Prishtine, 2009</p> <p>Dr.Sc. Agur Sokoli, “E Drejta Administrative”, Prishtinë 2014.</p> <p>Ermir Dobjani; Erlir Puto; Elsa Tostka; Erajd Dobjani, Kontrolli mbi administratën publike, Tirane, 2013.</p>
Literatura shtesë:	
	<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës</p> <p>Ligji për konfliktet administrative i Republikës së Kosovës</p> <p>Ligji i procedurës së përgjithshme administrative i Republikës së Kosovës, nr. 05/L -031</p> <p>Kodi i procedurave administrative të Shqipërisë</p>

	Komentari i Kodit të procedurave administrative, Tiranë. 2004.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Shqyrtimi hyrës -Informimi për përmbajtjen e lëndës mësimore, literaturën dhe burimet juridike.
Java e dytë:	NË PËRGGJITHËSI MBI KONTROLLIN -Nocioni i kontrollit, qëllimi i kontrollit dhe llojet e kontrollit
Java e tretë:	KONTROLLI MBI ADMINISTRATËN -Domosdoshmëria e kontrollit të administratës -Nocioni dhe llojet e kontrollit të administratës -Kontrolli juridik i administratës -Kontrolli politik i administratës -Kontrolli administrativ i administratës -Kontrolli i jashtëm i administratës
Java e katërt:	KONTROLLI GJYQËSOR I ADMINISTRATËS -Kuptimi i kontrollit gjyqësor të administratës -Lindja dhe zhvillimi historik i kontrollit gjyqësor të administratës -Rëndësia dhe karakteristikat specifike të kontrollit gjyqësor të administratës -Kontrolli gjyqësor si formë e kontrollit të rregulluar plotësisht -Kontrolli gjyqësor si formë e kontrollit që realizohet me aplikimin e autorizimeve meritore
Java e pestë:	ELEMENTET E QASJES KOMPARATIVE TË KONTROLLIT GJYQËSOR TË ADMINISTRATËS -Modeli kontinental (europian) i kontrollit gjyqësor të administratës -Modeli anglo-amerikan i kontrollit gjyqësor i administratës -Kontrolli gjyqësor i administratës në Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe në Shqipëri. -Kontrolli i administratës nga ana e ombudsmanit
Java e gjashtë:	KONTROLLI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV -Kuptimi, qëllimi dhe rëndësia e konfliktit administrativ -Llojet e konfliktit administrativ -Konflikti administrativ objektiv dhe subjektiv -Konflikti administrativ i ligjshmërisë dhe juridiksionit të plotë

	-Konflikti administrativ paraprak dhe suplementar
Java e shtatë:	PUNIMET SEMINARIKE -Mbrojtja publike e punimeve seminarike
Java e tetë:	PALËT NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV -Paditësi në konfliktin administrativ -Ana e paditur në konfliktin administrativ -Personi i interesuar në konfliktin administrativ -Objekti i konfliktit administrativ -Sistemi i klauzolës gjenerale, sistemi i enumeracionit dhe sistemi i klauzolës gjenerale me enumeracionin negativ -Karakteristikat e aktit administrativ kundër të cilit mund të zhvillohet konflikti administrativ
Java e nëntë:	PROCEDURA E ZGJIDHJES SË KONFLIKTIT ADMINISTRATIV (PROCEDURA ADMINISTRATIVE-GJYQËSORE) -Parimet e procedurës administrative gjyqësore -Padia në konfliktin administrativ -Afati i padisë -Përmbajtja e padisë
Java e dhjetë:	PROCEDURA SIPAS PADISË NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV -Rrjedha e procedurës sipas padisë -Procedura paraprake sipas padisë -Procedura e rregullt sipas padisë -Hedhja poshtë e padisë për shkaqe formale -Pezullimi i procedurës administrative gjyqësore
Java e njëmbëdhjetë:	PËRFUNDIMI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV -Përfundimi i konfliktit administrativ me aktgjykim -Përfundimi i konfliktit administrativ me aktvendim -Aktgjykimi mbi refuzimin e padisë -Aktgjykimi mbi miratimin e padisë -Pjesët përbërëse të aktgjykimit -Detyrueshmëria e aktgjykimeve të paapelueshme të nxjerra në konfliktin administrativ
Java e dymbëdhjetë:	MJETET JURIDIKE NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV -Ankesa në procedurën administrative gjyqësore -Mjetet e jashtëzakonshme juridike në konfliktin administrativ -Rishikimi (përsëritja) i procedurës administrative gjyqësore -Kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor -Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
Java e trembëdhjetë:	PUNIMET SEMINARIKE -Mbrojtja publike e punimeve seminarike
Java e katërbëdhjetë:	-KONFLIKTI ADMINISTRATIV ME RASTIN E

	HESHTJËS SË ADMINISTRATËS -Nocioni dhe llojet e heshtjes së administratës -Konflikti administrativ dhe heshtja e administratës -Procedura administrative dhe heshtja e administratës -Modelet e rregullimit juridik të heshtjes të administratës në vendet të ndryshme -Kompensimi i dëmit nga puna e paligjshme e administratës -Juridiksioni i gjykatave administrative në zgjidhjen e kontesteve që dalin nga kontratat administrative -Kompensimi i dëmit të shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të paligjshëm -Ankesa kushtetuese kundër akteve individuale dhe veprimeve individuale të administratës
Java e pesëmbëdhjetë:	VLERËSIMI I MËSIMIT

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Respektimi i orarit në ligjëratë dhe ushtrime; ▪ Mos-lëshimi i sallës gjatë ligjëratave ose ushtrimeve; ▪ Ruajtja e integritetit akademik; ▪ Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor; ▪ Respektimi i rregullave gjatë provimit.